



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

Njoftim për shtyrjen e thirrjes

Afati për aplikimin në thirrjen për Ekspertizë për ngritjen e kapaciteteve të Këshillit Rinor të bashkisë Kavajë, Projekti “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë” shtyhet me 7 ditë kalendarike.

Afati i ri i aplikimeve është data 7 shkurt 2025.

Terma reference

Ekspertizë për ngritjen e kapaciteteve të Këshillit Rinor të bashkisë Kavajë
Projekti “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë”

Autoritet kontraktues: Instituti për Bashkitë e Shqipërisë
Rr. “Skerdilajd Llagami”, Ndr. 3/9, Tiranë
M31318452D

Data e publikimit: 20 janar 2025

Instituti për Bashkitë e Shqipërisë është një organizatë e shoqërisë civile, me interes të kontribuojë për progresin dhe zhvillimet lokale, rajonale dhe kombëtare, për një qeverisje të mirë dhe decentralizim përmes asistencës, kërkimeve, studimeve dhe trajnimeve profesionale, duke përdorur vetëm mjete dhe rrugë ligjore dhe demokratike.

IBSh ka nisur zbatimin e Projektit “E ardhmja e Bashkisë - ndërtuar mbi rini të fortë”, mbështetur nga bashkia Kavajë si pjesë e Programit ReLOaD2. Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 (ReLOaD2) është një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga PNUD në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë.

Në zbatim të këtij projekti, Instituti për Bashkitë publikon këtë njoftim për subjektet e interesuara për shërbimet e ekspertizës lokale të detajuara më poshtë.



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

1. Objektivi i ekspertizës

Objektivi i kësaj ekspertize është ngritja e kapaciteteve të Këshillit Rinor të bashkisë Kavajë përmes një trajnimi një ditor mbi organizimin dhe funksionim e Këshillit dhe përgatitjes së Rregullores së Brendshme të Këshillit.

2. Metodologjia

Eksperti lokal do të punojë së bashku me stafin e Institutit për Bashkitë dhe anëtarët e Këshillit Rinor për përgatitjen e kësaj detyre. Ekspertiza do të ofrohet si kombinim i punës kërkimore, takime online dhe takime fizike, konsultimit dhe prezantimit të draft dokumentit.

3. Detyrat specifike të ekspertit lokal

Detyrat specifike në mbështetje të Këshillit Rinor përfshijnë:

- 3.1 Përgatitja e strukturës së Trajnimit mbi organizimin dhe funksionimin e Këshillit Rinor. Trajnimi duhet të përfshijë çështje të legjislacionit përkatës, organizimi administrativ i Këshillit, veprimtaria e tij, marrëdhënia me bashkinë dhe aktorë të tjerë, praktika të mira. Struktura e trajnimit do të miratohet paraprakisht dhe më pas do të zhvillohet si material trajnimi, kurrikul dhe prezantim ppt.
- 3.2 Ofrimi i trajnimit një ditor në bazë të kurikulës së përgatitur në bashkinë Kavajë. Trajnimi duhet të mundësojë bashkëveprimin dhe angazhimin e pjesëmarrësve duke parashikuar kohë për diskutime. Eksperti është përgjegjës për përgatitjen e axhendës.
- 3.3 Përgatitja e draft Rregullores së Brendshme të Këshillit Rinor. Rregullorja duhet të përfshijë çështje të organizimit dhe funksionimit të përditshëm të Këshillit Rinor bazuar në legjislacionin në fuqi. Materiali duhet të përgatitet në gjuhën shqipe.
- 3.4 Konsultimi dhe finalizimi i Rregullores. Eksperti do të prezantojë draftin e përgatitur në një takim online me Këshillin Rinor dhe do të pasqyrojë në dokument rrekomandimet dhe sugjerimet e dhëna.

4. Materiale për tu dorëzuar

Eksperti duhet të përgatisë dhe dorëzojë materialet e mëposhtme:

- 4.1 Kurrikulën e Trajnimit mbi organizimin dhe funksionimin e këshillit
- 4.2 Prezantim ppt për Trajnimin
- 4.3 Axhendën e Trajnimit
- 4.4 Raport mbi trajnimin e zhvilluar
- 4.5 Rregulloren e Brendshme të Këshillit Rinor

5. Afati



Instituti për Bashkitë Shqiptare
'për qytete të qëndrueshme'

Ekspertiza duhet të ofrohet për 7 ditë pune gjatë muajit shkurt 2025. Data specifike e organizimit të trajnimit do të njoftohet 5 ditë kalendarike paraprakisht.

6. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë teknike dhe ekonomike. Kriteret teknike kanë 70% të pikëve të vlerësimit dhe kriteri ekonomik ka 30% të pikëve.

Subjektet e interesuara duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme teknike:

- 6.1 Të kenë mbaruar studimet e larta universitare në fusha si kuridik, shkenca sociale, administrim publik etj.
- 6.2 Të kenë eksperiencë të mëparshme në fushuën e qeverisjes vendore. Puna më Këshillat Rinor do të përbëjë avantazh.
- 6.3 Të ketë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e trajnimeve dhe në përgatitjen e dokumentave udhëzuese.

Kriteri ekonomik është respektimi i buxhetit të aktiviteteve sipas këtij njoftimi, qasja inovative dhe ndikimi i mjedis.

7. Buxheti

Buxheti maksimal për këtë ofertë është 154,000 lekë bruto. Pagesat do të kryhen të ndara sipas aktiviteteve përmes transfertave bankare deri në 5 ditë kalendarike pas aktivitetit. Pagesa për ofrimin e trajnimit është maksimalisht 44,000 lekë dhe për përgatitjen e Rregullores është 110,000 lekë. IBSH do të mbajë nga kjo pagesë 15% për tatimin në burim në rastin e personave që nuk janë të pajisur me NIPT. Pagesat do të behet nëpërmjet institucioneve bankare.

8. Aplikimi

Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 5.1 CV të azhornuar në gjuhën shqipe
- 5.2 Dokumenta mbështetëse mbi eksperiencë të mëparshme
- 5.3 Kopje të Kartës ID
- 5.4 Ofertën ekonomike përfshirë tatimin në burim.

Aplikimet duhet të dërgohen online në adresën e emailit info@iam.org.al dhe titulli i emailit duhet të jetë **Ekspertizë lokale për ngritjen e kapaciteteve të Këshillit Rinor të bashkisë Kavajë**. Afati për dorëzimin e aplikimeve është data 7 shkurt 2025, ora 16:00.